

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “DARFO ALBANIA” Sh.p.k.

Sot më datë 14 prill 2000,

Z. Gianfranco Banzato, qytetar italian, lindur më 6 janar 1937, në Cadoneghe, rezident në Padova (PD) Itali, Via Segala, nr. 2, (me adresë në Shqipëri: Tirana, Rruga Ismail Qemali, 27), në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë aksionere të së drejtës italiane të quajtur “DARFO” S.p.A., me seli zyrtare në Darfo (BS), Itali, Via Bonara, n. 12, në bazë të vendimit të asamblesë së ortakëve të marrë më 15 mars 2000, që i bashkangjitet këtij akti si Shtojca 1, përfaqësuar nga Av. Erinda Ballanca, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, 29 tetor 1973, me prokurë të posaçme që bashkangjitet si (Shtojca 2);

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar aktiviteti i të cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, të cilës i bashkëngjitet si Shtojcë (referuar si Shtojca 1).

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë është “DARFO ALBANIA” Sh.p.k.(më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 2

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Ismail Qemali, 27. Zyra operative mund të caktohet edhe pranë uzinës industriale të Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është 50 (pesëdhjetë) vjet duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Shoqërive në Gjykatën e Rrethit Tiranë deri në 31 dhjetor 2050.

Neni 4

- 4.1. Shoqëria do të ketë qëllim të riaktivizojë aktivitetin e prodhimit të ferro-kromit në uzinën e Elbasanit dhe për nxjerrjen e kromiteve në minierat e Prrenjasit dhe të Pojskës, duke përdorur për sa është e mundur know-how e impianteve “Darfo” S.p.A.
- 4.2. Shoqëria do të zhvillojë edhe këto aktivitete: rehabilitimin, modernizimin financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e minierave. Në çdo rast ky aktivitet do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar në 100.000 (njëqindmijë) lekë dhe përbëhet nga tërësisht nga kontributet në para të:

- Shoqëria aksionere sipas së drejtës italiane e quajtur “Darfo” S.p.A. ka kontribuar në para leke 100.000 (njëqind mijë), nëpërmjet depozitimit të një

LeB

shume të tillë në llogarinë bankare n. 4L2170 - 40, e hapur në favor të Shoqërisë pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, në selinë e Tiranës.

Neni 6

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, secila prej tyre me një vlerë minimale prej 1.000 (njëmijë) lekë dhe të gjitha të poseduara nga shoqëria aksionere e së drejtës italiane të quajtur Darfo S.p.A..

Neni 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Statuti.

Neni 8

Me anë të këtij akti emërohet si administrator i shoqërisë Z. Eduart BELEGU, qytetar shqiptar, lindur më 21 shkurt 1963, në Tiranë dhe po aty rezident në Rruga Abdyl Frashëri, Pall. 1, Pasaportë Nr. 1081281. Ai do të qëndrojë në këtë detyrë për tre vjet dhe mund të revokohet nga ortakët në çdo moment.

Neni 9

Ortakëve të rinj që mund të hyjnë në Shoqëri u kërkohet detyrimi për ruajtjen e sekretit përsa i takon dokumentacionit teknik, informacionit dhe eksperiencave të shkëmbyera reciprokisht dhe për ato me të cilat ata njihen gjatë zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 10

Kushtet e punës, shpërblimet, oraret e punës, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose individuale e punës, si edhe nga legjislati shqiptar në fuqi.

Neni 11

- 11.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e këtij Akti Themelimi, si edhe mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve të ardhshëm të mundshëm (përveç atyre që lindin nga raporte personale apo jashtë Shoqërisë) ose mosmarrëveshjet midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të shtrohen për zgjidhje miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve.
- 11.2. Në rast se mosmarrëveshja nuk arrihet të zgjidhet me mirkuptim, zgjidhja e saj do t'i besohet për një gjykatë kompetente shqiptare, me kusht që ortakët italianë të kenë të drejtë të kërkojnë në mënyrë alternative shtrimin e çështjes për zgjidhje prej një kolegji arbitrash. Procedura arbitrale do të bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në Statut.

Neni 12


Ky Akti Themelimi është hartuar në katër kopje në gjuhën italiane duke i bashkëngjitur edhe kopjen në shqip. Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Akti, versioni italisht do të jetë i veçimi version i detyrueshëm.

EB

* * * *

Tiranë më 14 prill 2000

Lexuar, nënshkruar



Për ortakun Darfo S.p.A.
Av. Erinda BALLANCA

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DARFO ALBANIA" Sh.p.k.**

**KAPITULLI I
EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "DARFO ALBANIA" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga Akti i saj i Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "DARFO ALBANIA" Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti

- 3.1. Shoqëria do të ketë qëllim të riaktivizojë aktivitetin e prodhimit të ferro-kromit në uzinën e Elbasanit dhe Burrelit dhe të nxjerrjë kromite në minierat e Ptrenjasit dhe të Pojskës si dhe në minierat e pasurimit të Bulqizës dhe Klosit duke përdorur për sa është e mundur know-how-un dhe impiantet e "Darfo" S.p.A.
- 3.2. Shoqëria do të zhvillojë edhe këto aktivitete: rehabilitimin, modernizimin financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e minierave. Në çdo rast ky aktivitet do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3.3. Shoqëria ka gjithashtu për objekt:
 - a. blerjen shitjen, shkëmbimin dhe drejtimin e ndërmarrjeve dhe komplekseve industriale, të impianteve dhe stabilimenteve për kërkimin, distribucionin, transportin dhe tregtimin e burimeve të energjisë elektrike dhe të materialeve energjitike dhe derivateve të tyre në limitet e parashikuara nga ligji;
 - b. blerjen, shitjen, shkëmbimin dhe drejtimin e guroreve për nxjerrjen e materialeve të kuareit dhe të fabrikave për prodhimin e lidhjeve të hekurit në përgjithësi, prodhimin dhe tregtimin e lidhjeve të hekurit; importimin dhe eksportimin e lëndëve të para, produkteve gjysëm të përpunuara dhe produkteve përfundimtare që lidhen me prodhimin metalurgjik të stabilimenteve dhe minierave në Shqipëri;
 - c. blerjen, shitjen, shkëmbimin, pjesëmarrjen në shoqëri të ndërmarrjeve apo të degëve të ndërmarrjeve, të japin e të marrin me qera apo në huapërdorje të pasurive industriale, urbane e rurale, duke përfshirë vendosjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të shoqërisë për ndërtimin e këtyre ndërtesave;
 - f. shoqëria mundet gjithashtu të kryejë të çdo lloj veprimi që lidhet me pasuri të luajtshme e të pajuajtshme, veprime bankare dhe financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, duke përfshirë krijimin e filialeve, degëve, agjencive dhe të depozitave të

MS

mbajtura nga administratori apo administratorët të nevojshme për arritjen e objektivit të shoqërisë, si dhe të marrë pjesë, në mënyrë direkte apo indirekte, në shoqëri italiane dhe të huaja me objekt të ngjashëm, të lidhura apo në raport bashkëpunimi mes tyre. Gjithashtu Shoqëria mundet, pa asnjë kufizim, të financojë dhe të lërë garanci, ose të hipotekojë në favor të ndonjë banke apo instituti krediti për llogari të shoqërive të kontrolluara nga ajo apo që lidhen me Shoqërinë, si dhe për llogari të shoqërisë nën kontrollin e së cilës Shoqëria ndodhet. Shoqëria mund ta ushtrojë aktivitetin e saj si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Neni 4 – Selia

4.1. Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në Rruga M. Gjollësia. Selia operative e Shoqërisë mund të caktohet edhe pranë uzinës industriale të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër mund të bëhet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përbëjnë të paktën $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themelor.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë për 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

5.2. Shoqëria mund të mbarojë përpara këtij afati ose mund të zgjatet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

Neni 6 – Përgjegjësia

6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.

6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emër të tyre personal ndaj personave fizikë ose juridikë, privatë apo publikë si dhe Shtetit.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Neni 7 – Kapitali themeltar

7.1. Kapitali themeltar është 60.000.000 (gjashtëqind milion) lekë.

7.2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) pjesë kapitali të cilat kanë vlerën prej 1.000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara.

Neni 8 – Kontributet dhe pjesët e kapitalit

8.1. Dardhja e kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme:

- Shoqëria aksionere e së drejtës italiane e quajtur "Darfo" S.p.A., me seli ligjore në Darfo (BS), Italia, Via Bonara nr. 12 e përfaqësuar ligjërisht, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Administrativ, nga Z. Gianfranco BANZAFO, qytetar italian, lindur më 6 janar 1937, në Cadoneghe (Itali), e banues në Padova (Itali), në Via Segala 2, ka kontribuar në para 60.000.000 (gjashtëdhjetë milion) lekë, nëpërmjet depozitimit të një shume të tillë në llogarinë bankare nr. 20027135302, e hapur në favor të Shoqërisë pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, në selinë e Tiranës.

8.2. Sipas kontributeve të sipërpërmendura në Shoqëri:

Shoqërisë aksionere të së drejtës italiane "Darfo" S.p.A. i takojnë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) pjesë kapitali, që përfaqësojnë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Neni 9 – Rritjet e kapitalit themeltar

- 9.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufij në çdo moment një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve që përfaqësojnë së paku $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit të shoqërisë.
- 9.2. Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se ata nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive.

Neni 10 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimi të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve që përfaqësojnë së paku $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit të shoqërisë. Në asnjë rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 10.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në mënyrë proporeionale me pjesët e kapitalit të zotëruara.

Neni 11 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 11.1. Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve që përfaqësojnë së paku $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit të shoqërisë.
- 11.2. Në rast transferimi me çfarëdolloj titulli të pjesëve të kapitalit tek të tretët, ortakët e tjerë të Shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes së pjesëve të kapitalit, në raport me pjesët e tyre të kapitalit me të njëjtat kushte e me të njëjtin çmim që i janë ofruar palës së tretë.
- 11.3. Në këtë rast ortaku që do të shesë u njofton ortakëve të tjerë çmimin e ofruar prej të tretit, duke u paraqitur edhe provën me shkrim të ofertës, dhe ortakët e tjerë kanë 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i marrjes së letrës për t'i komunikuar ortakut që do të shesë dhe ortakëve të tjerë dëshirën e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej të drejtës së tyre të parablerjes.

Handwritten signature

- 11.4. Në rast se njëri prej ortakëve të cilit i bëhet oferta për të blerë sipas së drejtës së parablerjes nuk dëshiron ta ushtrojë këtë të drejtë, ortakët e tjerë të cilët kanë përfituar e ushtruar tashmë të drejtën e tyre të parablerjes për pjesën e tyre, mund ta ripërdorin këtë të drejtë mbi të gjitha ose një pjesë të pjesëve të kapitalit të cilit i ishin ofruar sipas së drejtës së parablerjes ortakut që nuk dëshironte ta ushtronte atë.
- 11.5. Në rast se disa ortakë dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara sipas së drejtës së parablerjes së ortakut që nuk dëshironte ta ushtronte atë të drejtë, ndahen në pjesë të barabarta.
- 11.6. Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara mbi bazën e së drejtës së parablerjes ortakut që nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, do t'i transferohen atij tërësisht ose në atë masë që ai synon të blejë.
- 11.7. Për këtë qëllim, ortakët e interesuar që do të përdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'ia njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të shesë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes.
- 11.8. Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura bëhen me shkrim.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT, KONTROLLI

Neni 12 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat përkatëse

- 12.1. Organi vendim marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 12.2. Vendimet që merr ky organ me shumicë votash janë të detyrueshme për ortakët që mungojnë ose që kanë mendim të kundërt, me përjashtim të rastit kur kanë të drejtën e ankimit, e drejtë kjo e cila ushtrohet në rastet, kohën dhe format që parashikohen nga ligji.

Neni 13 – Të drejtat e pjesëmarrjes dhe të votimit

- 13.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në çdo Asamble, të paraqesë mendimin e vet dhe të japë aq vota sa pjesë të kapitali themeltar ka derdhur.
- 13.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një delegat i pajtur me një prokurë të shkruar, me anë të së cilës mund të japë votën e tij.
- 13.3. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar për një pjesë të kapitalit, nëse voton personalisht për tjetrën.

Neni 14 – Thirrja e Asamblesë

- 14.1. Asambleja e Zakonshme thirret të paktën një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit për miratimin e bilancit, të raporteve të administratorëve dhe të ekspertit kontabël, dhe inventarit.

PS

- 14.2. Asambleja mund të thirret në çfarëdoqj momenti nga administratori/ët ose nga eksperti kontabël të autorizuar, ose nga likuidatori/ët, si edhe nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë më tepër se 1/10 (një e dhjeta) e kapitalit themeltar.
- 14.3. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet një leure rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve - në adresat që janë shkruajtur në Librin e Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar) të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet për t'u trajtuar dhe për t'u vendosur, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 14.4. Asambleja do të mbahet rregullisht edhe pa respektuar këto formalitete, nëse marrin pjesë apo janë të përfaqësuar të gjithë ortakët, të gjithë administratorët dhe eksperti kontabël (nëse është emëruar). Asambleja e Zakonshme vendos mbi të gjitha çështjet që nuk janë në kompetencën e Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe specifíkisht vendos mbi:
- a. emërimin apo zëvendësimin e Administratorëve dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar);
 - b. miratimin e planeve të prodhimit;
 - c. organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit;
 - d. miratimin e bilancit paraprak;
 - e. miratimin e llogarive vjetore;
 - f. miratimin e relacionit të administratorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, dhe inventarin;
 - g. vendimin mbi shpërndarjen e fitimeve.
- 14.5. Asambleja e Zakonshme quhet e mbledhur rregullisht dhe mund të marrë vendime nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, dhe vendimet merren me votën *pro* të shumicës së ortakëve të pranishëm.
- 14.6. Nëse mungon numri i nevojshëm i pjesëmarrësve, Asambleja e zakonshme duhet të thirret për herë të dytë dhe mund të vendosë me shumicë, pavarësisht nga numri i ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar dhe votues, me përjashtim të rastit kur emërohen ose revokohen Administratorët. Në këtë rast, ortakët e pranishëm dhe votat e dhëna nga ortakët që votojnë ose që janë të përfaqësuar, duhet të jenë mbi 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë edhe në rast të një thirrje të dytë.
- 14.7. Asambleja e Jashtëzakonshme është e mbledhur në mënyrën e duhur dhe merr vendime në thirrjen e parë me pjesëmarrjen e të paktën $\frac{1}{4}$ (tre të katërtave) të kapitalit dhe me votën *pro* të shumicës së ortakëve të pranishëm.
- 14.8. Në rast se mungon numri i duhur i të pranishmëve, Asambleja e Jashtëzakonshme duhet të mblidhet në thirrjen e dytë dhe mund të vendosë me shumicë votash pavarësisht nga numri i ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar me të drejtë vote.
- 14.9. Asambleja e Jashtëzakonshme vendos:
- a. mbi ndryshimet e aktit të themelimit dhe të Statutit;
 - b. mbi formimin e filialeve, degëve dhe përfaqësive jashtë shtetit;
 - c. mbi rritjen apo reduktimin e kapitalit të shoqërisë;
 - d. mbi ndryshimet në objektin e shoqërisë dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera;
 - e. mbi transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar;

c. mbi emërimin dhe revokimin e likuidatorëve.

- 14.10. Çdo mbledhje drejtohet nga një ortak, ose një person tjetër i caktuar nga Asambleja. Për mbajtjen e procesverbalit Asambleja cakton një Sekretar, i cili mund të mos jetë ortak.
- 14.11. Vendimet e Asamblesë duhet të shkruhen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari. Në procesverbal duhet të përfshihen të përmblendhura, me kërkesën e tyre, edhe deklaratat e ortakëve.
- 14.12. Asambleja mund të thirret dhe mbahet në çfarëdolloj vendi të treguar në thirrje, në Shqipëri apo jashtë saj.

Neni 15 – Administrimi

- 15.1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen ose revokohen nga Asambleja e Zakonshme.
- 15.2. Administratori qëndron në postin e tij për sa kohë vendos Asambleja e Ortakëve.
- 15.3. Administratori i Vetëm apo Këshilli Administrativ ka të gjitha kompetencat administrative të zakonshme dhe të jashtëzakonshme që bëjnë pjesë në objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me anë të prokurës së posaçme. Asambleja mund të japë dhe/ose revokojë dhe/ose shpërndajë kompetencat e çdo administratori të emëruar.
- 15.4. Mbledhjet e Këshillit administrativ apo të administratorëve mund të zhvillohen në Shqipëri apo jashtë saj, si dhe nëpërmjet telekonferencave apo videokonferencave, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe të kenë mundësinë të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht në të. Në këtë rast, mbledhja do të konsiderohet e mbajtur atje ku ndodhen dhe Kryetari dhe Sekretari, të cilët do të emërohen posaçërisht rast pas rasti, në mënyrë që të jetë e mundur përgatitja dhe firmosja e procesverbalit të mbledhjes.

Neni 16 - Eksperti kontabël i autorizuar

- 16.1. Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar për një periudhë 3 (tre) vjeçare (dhe i rizgjedhshëm) nga Shoqëria, me votën *pro* të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 16.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjtën procedurë si ajo e emërimit.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17 Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 17.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
- 17.2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

MS

- 17.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, në se ka, miratohen nga Asambleja me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 17.4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 18 – Fitimet

- 18.1. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë përqind) që caktohen për rezervën ligjore deri sa të arrihet 10% (dhjetë përqind) e kapitalit themeltar dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja dëshiron t'i vërë mënjane, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar respektivisht.
- 18.2. Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të jashtëzakonshme në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyerjen e shpërndarjes së fitimeve plotësisht ose pjesërisht në shërbimet e mëposhtme.

KAPITULLI V MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 19 – Mbarimi

- 19.1. Shoqëria mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.
- 19.2. Shoqëria nuk mbaron në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 20 – Likuidimi

- 20.1. Në rast mbarimi, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 20.2. Për ta administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohët e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 20.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit të Shoqërisë, Asambleja do të vendosë, me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 20.4. Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'u shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve në proporcion me pjesët e zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 21 – Transformimi i Shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite vetëm me miratimin unanimit të ortakëve, ndërsa mund të shndërrohet në shoqëri anonime me miratimin e shumicës së ortakëve që mbajnë më shumë se $\frac{1}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 22 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 22.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin apo zgjidhjen e këtij Statutit dhe të Aktit të Themelimit të Shoqërisë dhe, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet të interesuarve.
- 22.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo mund t'i besohet një gjykatë shqiptare, përveç rastit kur ortakët italianë ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar besimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga arbitrazhi. Arbitrazhi përbëhet prej 5 arbitrash, 4 prej të cilëve emërohen nga respektivisht prej palëve, dhe i pesti më funksionin e kryetarit, i emëruar nga arbitrat, ose në rast se nuk arrihet në mirkuptim për zgjedhjen e kryetarit, do të caktohet prej Kryetarit të Gjykatës së Tiranës brenda 30 ditësh prej bërjes së kërkesës prej palës më të interesuar. Gjithsesi, përpara krijimit të Gjykatës së Arbitrave, secila prej palëve mund të kërkojë marrjen e masave të jashtëzakonshme për të siguruar objektin e padisë prej Gjykatës së Tiranës. Këto masa do të konfirmohen ose revokohen prej Gjykatës së Arbitrave.
- 22.3. Arbitrazhi do të vendosë me paanësi e në mënyrë të njëlojtë për palët duke depozituar vendimin brenda 90 ditëve prej datës së pranimit të detyrës së arbitrit të tretë. Vendimi i Kolegjit të Arbitrave është i paapelueshëm.
- 22.4. Vendi i arbitrimit do të jetë Tirana. Gjuha e arbitrimit do të jetë gjuha italiane.

Neni 23 - Gjuha

Ky Statut është përgatitur në katër kopje në gjuhën italiane duke i bashkëngjitur përkthimin në gjuhën shqipe. Për të gjitha konfliktet që mund të lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e Statutit, versioni italisht do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

* * * * *

Tiranë më 26 qershor 2001

Lexuar dhe nënshkruar



Për ortakun e vetëm "Darfo" S.p.A.
Z. Massimo Simbula